



Komuna e Klinës

Zyra e Kryetarit

01Nr. 10-5129 /2025

Klinë, datë 20/01 /2025

Duke u bazuar ne nenin 13 dhe 58 te Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040 publikuar në Gazeten Zyrtare nr.28/2008, Nenin 91 të Statutit të Komunës së Klinës të vitit 2010, si dhe duke u bazuar në vendimin e kuvendit te Komunës e Klinës nr.01-06-3509/2022 të datës 28.01.2022, si dhe faktin e mos pagesës se disa anëtareve të komitetit për komunitete, kryetari i Komunës së Klinës, mori këtë:

V E N D I M

1. **LEJOHET**, kompensimi i anëtareve të Komitetit të Komuniteteve në mënyrë retroaktive, te cilët nuk janë kompensuar për takimet e mbajtura gjate vitit 2023-2024, në shumen ekuivalente më anëtarët e Komitetit për Politike dhe Financa, në përputhje më aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Kompensimi i anëtareve të komitetit sipas ketij vendimi duhet të behet deri në përfundimin e mandatit të tyre. Pagesa e mjeteve behet nga kodi buxhetor mallra dhe shërbime.
2. Për ekzekutimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit, e cila autorizohet të kryej të gjitha veprimet e nevojshme procedurale lidhur më ekzekutimin e tij.
3. Ky vendim është i plotfuqishëm dhe hynë në fuqi menjëherë.

Te njoftohen:

- DFEZH;
- Anëtarët e komitetit, si dhe;
- Arkivi.

Kryetari,
Zenun ELEZAJ

